

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6699
E mërkurë, 7 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Hoxhaj: Kosova dy vjet pa njohje, kjo është politika e jashtme e rënies së lirë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MACRON DHE SCHOLZ ANGAZHOJNË KËSHILLTARË PËR TË NDIHMUAR NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5

KURTI MBËSHTET INTERESIMIN E GJERMANISË DHE TË FRANCËS PËR TË NDIHMUAR NË DIALOG



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se e mbështetin interesimin e Gjermanisë dhe të Francës për të ndihmuar në procesin e dialogut Kosovë - Serbi për marrëveshjen që ka në qendër njohjen reciproke. "Ne e mbështesim faktin që dy shtete kaq të rëndësishme

evropiane dhe njohëse të vendit të Kosovës, vendit tonë, republikës sonë që nga fillimi, do ta ndihmojnë ndërmjetësimin e Brukselit për një marrëveshje ligjërisht të obligueshme që ka në qendër njohjen reciproke", ka thënë të martën kryeministri Kurti

OPINION

HOXHA DHE FERRAJ, BIJTË POLITIKË TË MUHO ASLLANIT DHE LENKA UKOS!

F. 6-7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



SLLOVENIA THËRRET NË BISEDË AMBASADOREN SERBE PAS DEKLARATAVE TË VUÇIQT PËR KOSOVËN

F. 2

LIZ TRUSS MERR MANDATIN E KRYEMINISTRES NGA MBRETËRESHA

F. 2

EKONOMI



AKK-ja SHQYRTON PROJEKTLIGJIN PËR ZYRTARËT PUBLIKË DHE PROJEKTLIGJIN PËR PAGA

F. 8

ODA E AFARIZMIT: RRRITJA E PAGAVE NË SEKTORIN PRIVAT, VËSHITËRE E REALIZUESHME

F. 8

SPORT

KLUBET E KOSOVËS MËSOJNË KUNDËRSHTARËT NË KUPËN EVROPIANE

F. 10



LAVDËROHET PUNA E POLICISË SË KOSOVËS NË 23-VJETORIN E THEMELIT

FAQE 3



LDK-ja: PAKOJA E QEVERISË, JOEFKTIVE DHE DISKRIMINUESE

FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Slovenia thërret në bisedë ambasadorin serbe pas deklaratave të Vuçiqit për Kosovën

LUBJANË, 6 SHTATOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Sllovenisë ka ftuar në bisedë ambasadorin serbe për shkak të deklaratave të bëra nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Vuçiq, gjatë vizitës së fundit të presidentit sloven Borut Pahor në Beograd, tha se Sllovenia, sikurse edhe shtetet e tjera që e njohin Kosovën, kanë shkelur integritetin territorial të Serbisë.

MPJ e Sllovenisë ftoi në bisedë ambasadorin serbe në Lubjanë, Zorana Vlatković, për të biseduar për këto deklaratave të Vuçiqit i bërë gjatë në një konferencë për medie lidhur me vizitën e Pahorit në Serbi.

Ambasadori sloven në Serbi, Damjan Bergant, po ashtu është ftuar në bisedë për temën e njëjtë, ka njoftuar ministria slovene për N1.

Presidenti serb, pas takimit me Pahorin në Beograd, ishte pyetur nga gazetarët pse Serbia nuk po i vendos sanksione Rusisë dhe ai

ishte përgjigjur duke pyetur: “Si t’ua shpjegoj qytetarëve se Serbia po i vendos sanksione Rusisë e jo Sllovenisë?”. “Rusia nuk e ka shkelur integritetin territorial të Serbisë. Sllovenia e ka shkelur. Dhe, siç e shihni, ne kemi raporte të mira me Slloveninë”, tha Vuçiqi dhe shtoi se Sllovenia, sikurse për shembull Franca, Gjermania dhe ShBA-ja, që e njohin pavarësinë e Kosovës, sipas qëndrimit të Serbisë, po shkelin ligjin ndërkombëtar, Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit.

Ministria e Punëve të Jashtme e Sllovenisë tha se ishte shumë e befusuar nga deklaratat e Vuçiqit. “Edhe një herë ne përsërisim qëndrimin tonë lidhur me Kosovën, që Sllovenia e njeh si shtet të pavarur dhe sovran. Në këtë drejtim, ne shprehim pritjet tona që Serbia në të ardhmen të mos e problematizojë qëndrimin tonë karshi Kosovës sepse mbështetja e Sllovenisë për



Kosovën nuk është e drejtuar kundër Serbisë. Ne, po ashtu, shprehim kundërshtinë që njohja e Kosovës nga Sllovenia të krahasohet me agresionin rus kundër Ukrainës”, u tha në deklaratën e Lubjanës.

Ministria e Jashtme e Sllovenisë gjithashtu tha se pret që

bashkëpunimi aktual me Serbinë të vazhdojë dhe se Lubjana do të vazhdojë të avokojë për komunikim me Beogradin, në të gjitha nivelet. “Ne duam që shtetet të vazhdojnë të zhvillojnë raporte miqësore dhe së bashku të shikojnë për mundësi që të zgjidhen çështjet e hapura në

Ballkanin Perëndimor, që do t’i ulnin tensionet në rajon. Kjo do t’u mundësonte Kosovës dhe Serbisë që të bënin përparim në rrugën drejt BE-së”, u tha në njoftim.

Kosova ka shpallur pavarësinë më 2008 dhe që atëherë është njohur nga 117 shtete të botës.

Liz Truss merr mandatin e kryeministres nga Mbretëresha



LONDËR, 6 SHTATOR - Mbretëresha Elizabeth II emëroi të martën Liz Truss kryeministre të Britanisë. Truss fitoi dje garën në Partinë Konservatore, duke siguruar postin e lideres së kësaj partie dhe të kryeministres së re të Britanisë së Madhe. “Mbretëresha priti sot në audiencë të nderuarën Truss dhe i kërkoi asaj që ta formonte administratën e re”, tha Pallati Buckingham në një deklaratë.

Sipas pallatit mbretëror, Truss pranoi ofertën e Mbretëreshës dhe “i puthi duart pas emërimit kryeministre”.

Truss zëvendëson Boris Johnsonin, i cili u detyrua të largohej nga ky post pas tri viteve të trazuara në pushtet.

Johnsoni dhe Truss udhëtuan për në Skoci për t’u takuar me

Mbretëreshën Elizabeth II, ku Johnsoni zyrtarisht dorëzoi dorëheqjen dhe Truss u ftua që ta formojë qeverinë.

Kryeministria e re do të përballet me një nga listat më të frikshme të problemeve të çdo lideri të pasluftës në Britani, pasi inflacioni arrin në numër dyshifrorë, kostoja e energjisë është rritur dhe Banka e Anglisë paralajmëron për një recesion të gjatë deri në fund të këtij viti.

Takimet e Mbretëreshës me kryeministrat tradicionalisht mbahen në Pallatin Bakingam në Londër, por monarkistja 96-vjeçare së fundmi është përballur me probleme shëndetësore dhe e zhvilloi këtë takim në Skoci, aty ku zakonisht i kalon pushimet e verës.

VMRO-ja zyrtarizon nismën për referendum kundër marrëveshjes me Bullgarinë

SHKUP, 6 SHTATOR - Partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE ka njoftuar të martën fillimin e procedurës për organizimin e referendumit të detyrueshëm me qëllim të anulimit të marrëveshjes me Bullgarinë. Kjo marrëveshje e propozuar nga Franca dhe e miratuar në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut dhe atij të Bullgarisë i hapi rrugën shtetit maqedonas që t’i nisë bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 19

korrik. Në bazë të marrëveshjes, Shkupi gjatë procesit të bisedimeve me BE-në duhet t’i zgjidhë çështjet e hapura lidhur me aspektet historike, ndërsa ato për gjuhën dhe identitetin beson se nuk do të jenë pjesë e bisedimeve.

Çështja kryesore ka të bëjë me përfshirjen e pakicës bullgare në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut si popull shtetformues. Opozita maqedonase marrëveshjen e quan “tradhti kombëtare” andaj edhe ka

inicuar referendumin me pyetjen “A jeni për anulimin e Marrëveshjes me Bullgarinë?”. “Me këtë marrëveshje mohohen gjuha, identiteti dhe historia maqedonase. Kjo nismë për referendum është tërësisht evropiane sepse kundërshton politikat dhe veprimet negative që Bullgaria i drejton ndaj Maqedonisë në aspektin gjuhësor, kulturës dhe identitetit”, ka deklaruar Nikolla Micevski, kryetar i grupit parlamentar të VMRO DPMNE-së.



Lavdërohet puna e Policisë së Kosovës në 23-vjetorin e themelimit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Policia e Kosovës ka shënuar 23-vjetorin e themelimit. Për nder të kësaj dite të martën është mbajtur një ceremoni shtetërore, në të cilën drejtuesit e institucioneve shtetërore kanë vlerësuar lart punën e policisë. Sipas tyre, Policia e Kosovës është histori suksesi. Fillimisht, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka thënë se Policia e Kosovës është jo vetëm një nga hallkat më të rëndësishme të shtetit, por edhe histori suksesi për vendin.

Derisa i kujtoi të gjithë policët e rënë në krye të detyrës, shefja e shtetit tha se pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë mbrojtur dhe mbikëqyruar kufijtë e Kosovës. "Policia e shtetit tonë, me të gjitha segmentet e saj, përbën jo vetëm njëri nga hallkat e rëndësishme të shtetit, por edhe njëri nga historitë më të suksesshme se si mund të themelojmë e të ngrehim institucione të qëndrueshme, besueshmëria e të cilave ka qenë vazhdimisht e lartë në mesin e qytetarëve tanë. Prandaj, dua që me këtë rast t'ua uroj të gjithë pjesëtarëve të policisë sonë përvjetorin e themelimit dhe t'i falënderoj në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të gjithë qytetarëve që përfaqësojmë për angazhimin e policisë përgjatë gjithë këtyre 23 vjetëve. Ju keni qenë vazhdimisht një ndër shtyllat e fuqishme të shtetit tonë, por edhe garantuesit e përhershëm të sigurisë së jetës e të pronës së qytetarëve të vendit", ka thënë Osmani, duke kujtuar edhe policët e rënë në detyrë. "Në veçanti do të doja që sot t'i kujtojmë policët të cilët kanë rënë në detyrë, duke nisur nga heroi ynë kombëtar Enver Zymberi dhe policët e tjerë të cilët nuk kursyen asgjë, as jetët e tyre, për t'i shërbyer atdheut. Ata janë kujtesa jonë e përhershme, por duhet të vazhdojmë të mbeten edhe motivimi ynë i përhershëm për t'i dalë zot atdheut e për t'u shërbyer me nder të gjithë qytetarëve tanë. Në 23 vitet e ekzistimit të saj, Policia e Kosovës ka dëshmuar se angazhimi për vendin, shërbimi

ndaj tij, është nder e ideal, sepse ideali për t'i shërbyer vendit e për të qenë pranë secilit qytetar të vendit nuk mund të kushtëzohet nga shtyssa të tjera, e ju i keni shërbyer secilit qytetar, pa dallim etnie e feje, ose dallime të tjera e u jeni gjetur pranë atyre e keni krijuar siguri për të jetuar të qetë në vendin tonë", është shprehur Osmani.

Ajo ka thënë se krahas partnerëve ndërkombëtarë, policia ka dhënë kontribut të çmuar në ruajtjen dhe forcimin e sovranitetit. Më tutje, Osmani ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në Interpol është shumë i rëndësishëm. "Policia e Kosovës, krahas edhe partnerëve të tjerë, është kujdesur po kështu që kufijtë e vendit tonë të mbrohen e të mbikëqyren e të jenë pika të mundësimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve e asnjëherë pengesë e qarkullimit të tyre. Kësaj, ju keni ndihmuar në ruajtjen dhe forcimin e sovranitetit të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës është e vendosur që t'i zhvillojë gjithnjë e më shumë strukturat e policisë, ta rrisë barazinë gjinore në të dhe në të gjitha strukturat tona të sigurisë duke e ndihmuar policinë qoftë me pajisje, qoftë me edukim profesional dhe me mbështetje të vazhdueshme, në mënyrë që ajo të vazhdojë të mbetet garantuese e sigurisë së qytetarëve dhe të integrohet gjithnjë e më shumë në organizmat ndërkombëtarë të rendit e të sigurisë. Kësaj, ne e garantojmë jo vetëm sigurinë e qytetarëve, por bëhemi edhe faktorë të rëndësishëm për ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare. Prandaj, anëtarësimi në Interpol dhe organizata të tjera të kësaj fushe është shumë i rëndësishëm për arritjen e këtyre qëllimeve", është shprehur Osmani.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka bërë thirrje policisë të jetë në nivel më të lartë të detyrës kudo në çdo rrugë e cep të vendit. Kurti është shprehur se janë të vetëdijshëm për sfidat e këtij institucioni, prandaj edhe ka ofruar mbështetje për krijimin e një policie model që mund t'u përgjigjet të gjitha situatave. Ai ka theksuar se integriteti moral dhe personal janë shtylla të



domosdoshme për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. "Javën që shkoi ne u ballafaquam me një rast shumë të rëndë, një vajzë e mitur e cila do të duhej të ishte në bankat shkollare në klasën e pestë apo gjashtë. Ajo ndodhet në strehimor për shkak të një krimi që ndodhi mbi të nga pesë dhunues. Dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është çështje private, por çështje e sigurisë dhe mirëqenies publike sociale. Andaj, nga ju pritet dhe kërkohet të jeni në nivelin më të lartë të detyrës tuaj kudo në çdo rrugë e në çdo cep të vendit. Mbani me përgjegjësi detyrat tuaja ashtu siç edhe ne si qeveri i mbajmë përgjegjësitë tona ndaj jush dhe ndaj secilit qytetar të vendit. Trasoni rrugë lehtësisht të kalueshme për të gjithë, por edhe për brezat e ri që do të vendosin ta vazhdojnë rrugën tuaj. Për këtë kohë sa bashkëpunojmë ju keni dëshmuar se jeni të pakompromis në luftën që i keni shpallur krimin dhe për këtë janë rezultatet tuaja që dihen jo vetëm në Kosovë, por botërisht. Nuk jeni ndalur, ndonëse nga bandat e ndryshme ju janë drejtuar armët e ju janë shkrepur plumbat", theksoi Kurti. Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, është shprehur se do të punojnë pareshitur për ngritjen e integritetit të Policisë së Kosovës. "Një ndër sfidat kryesore të Policisë së Kosovës që nga themelimi është shtrirja e sovranitetit e ligjshmërisë

në çdo cep të Kosovës, në veçanti në veri të saj. Muajt e fundit së bashku jemi ballafaquar me tentativa të vazhdueshme të strukturave kriminale të udhëhequra drejtpërdrejt dhe të mbështetura fuqishëm nga Serbia për ta destabilizuar jo vetëm veriun e vendit. Zotimi ynë për ndryshim tashmë vërehet qartë e sidomos në pjesën veriore të vendit. Për çdo ditë e më shumë rendi e ligji po forcohet atje dhe veprimtaria e institucioneve në shërbim të qytetarëve po zgjerohet. Stabilitetin në vendin tonë do ta sigurojmë duke respektuar ligjet dhe praktikat më të mira", ka thënë Sveçla. Kurse ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, ka thënë se zyrtarët policorë janë ballafaquar me sfida të ndryshme por që, sipas tij gjithmonë u janë përgjigjur pa hezitim. Hoti ka thënë se Policia e Kosovës në vazhdimësi është duke i luftuar grupet e organizuara kriminale, derisa është shprehur se edhe siguria e trafikut rrugor mbetet prioriteti i tyre. Më 6 shtator 1999 Misioni i OSBE-së në Kosovë, në pajtim me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244, kishte hapur Shkollën e Policisë, duke filluar trajnimin e kandidatëve për pjesëtarë të Policisë së Kosovës e cila gjeneratë numëronte 176 pjesëtarë. Aktualisht, Policia e Kosovës numëron rreth 9 000 punonjës.

Krasniqi dhe Haradinaj kërkojnë që policia të trajtohet me dinjitet

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se Policia e Kosovës mbetet një ndër institucionet më të shquara, ndonëse policët nuk kanë paga dinjitoze e kushte jo të favorshme të punës. Krasniqi në 23-vjetorin e themelimit të policisë ka lavdëruar punonjësit e këtij institucioni duke thënë se është përherë mirënjohës. "23 vjet më parë Kosova u bë me Shërbimin Policor të Kosovës, që më pas u shndërrua në polici të Kosovës, për t'i hapur rrugë mbrojtjes së qytetarëve, rendit dhe ligjit në vendin tonë. Aktualisht policia jonë, ndonëse me kushte jo të favorshme të punës e pa paga dinjitoze, mbetet një ndër institucionet më të shquara që ofron shërbim e siguri për secilin, pa dallim. Respekt për punën dhe angazhimin e mijëra grave e burrave që ndër vite kanë vendosur të shërbejnë në Policinë Kosovës, duke iu përmbajtur me dinjitet vizionit, misionit dhe vlerave të këtij profesioni fisnik. Përherë mirënjohës!", ka shkruar Krasniqi.

Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Policia e Kosovës është storie e suksesit. "Në njëzet e tre vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës i përgëzoj të gjithë pjesëtarët e policisë për shërbimin e tyre dhe kujtoj me nder e respekt ata që ranë në krye të detyrës. Policia e Kosovës është storie suksesi për Republikën e Kosovës, andaj shteti vazhdimisht duhet të bëjë të pamundurën që t'i trajtoj me dinjitet, me paga të dinjitetshme dhe me krijimin e kushteve në përputhje me kompleksitetin e detyrave që kryejnë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".





MACRON DHE SCHOLZ ANGAZHOJNË KËSHILLTARË PËR TË NDIHMUAR NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI

Kurti mbështet interesimin e Gjermanisë dhe të Francës për të ndihmuar në dialog

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se e mbështesin interesimin e Gjermanisë dhe të Francës për të ndihmuar në procesin e dialogut Kosovë - Serbi për marrëveshjen që ka në qendër njohjen reciproke. “Ne e mbështesim faktin që dy shtete kaq të rëndësishme evropiane dhe njohëse të vendit të Kosovës, vendit tonë, republikës sonë që nga fillimi, do ta ndihmojnë ndërmjetësimin e Brukselit për një marrëveshje ligjërish të obligueshme që ka në qendër njohjen reciproke”, ka thënë të martën kryeministri Kurti

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se e mbështet interesimin e Gjermanisë dhe të Francës për ndihmë në dialogun me Serbinë. Ai ka thënë se këto dy shtete do të ndërmjetësojnë në Bruksel për një marrëveshje ligjërish të obligueshme që ka në qendër njohjen reciproke në mes të

Kosovës dhe Serbisë. “Kosova e kupton rëndësinë e integritetit evropian në zemër të të cilit për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, e për ne posaçërisht ndodhet Gjermania dhe Franca. Ne e mbështesim faktin që dy shtete kaq të rëndësishme evropiane dhe njohëse të vendit të Kosovës, vendit tonë, republikës sonë që nga fillimi, do ta ndihmojnë ndërmjetësimin e Brukselit për një marrëveshje

ligjërish të obligueshme që ka në qendër njohjen reciproke”, ka thënë Kurti të martën pas ceremonisë së shënimit të 23-vjetorit të Policisë së Kosovës. Ai ka ritheksuar se në pikat kufitare vlen reciprociteti ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Në pikat kufitare po vlen reciprociteti ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ne kemi insistuar për liri të lëvizjes dhe ajo do të nënkuptonte liri të plotë të

lëvizjes, meqenëse liria e cunguar nuk është liri dhe këtë gjë zëvendëskryeministri është duke e adresuar edhe me ndërmjetësim. Në pikat kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, padyshim që ajo vlen. Veçse unë e kuptoj se nuk mund të kemi liri të cunguar apo të pjesshme të lëvizjes”, është shprehur Kurti.

Presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelari gjerman Olaf Scholz thanë më 4 shtator se normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është thelbësor për Ballkanin Perëndimor. Ata thanë se i kanë ngarkuar këshilltarët e tyre për politikë të jashtme dhe siguri, Jens Plettner dhe Emmanuel Beaune, për t'i ofruar mbështetje

të drejtpërdrejtë përfaqësuesit special të BE-së për dialog, Miroslav Lajčak.

Macron dhe Scholz në një letër të përbashkët drejtuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, thanë se në dritën e agresionit rus ndaj Ukrainës, duhet të bëhen përpjekje më të forta që perspektiva evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor të bëhet realitet. “Për Ballkanin Perëndimor normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i një rëndësie kruciale”, thuhet në letër. Macron dhe Scholz u kanë bërë thirrje Kurtit dhe Vuçiqit që të tregojnë vendosmëri dhe gatishmëri maksimale për të marrë vendime të vështira, të

Hoxhaj: Kosova dy vjet pa njohje, kjo është politika e jashtme e rënies së lirë

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, e ka kritikuar qeverinë për politikën e jashtme, duke thënë se

Kosova ka bërë dy vjet pa asnjë njohje e asnjë anëtarësim. Hoxhaj në “Facebook” ka shkruar se Kosova ka bërë dy vjet pa asnjë

anëtarësim dhe njohje ndërkombëtare. “Sot Kosova bëri dy vjet pa asnjë njohje, asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare, asnjë

partneritet bilateral, asnjë marrëveshje me BE-në! Kjo është politika e jashtme e rënies së lirë”, ka shkruar Hoxhaj.



Policia arreston një person të dyshuar për kontrabandim të barnave

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Policia e Kosovës, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të veprave të kundërligjshme dhe kontrabandës në pikat kufitare, ka shtuar kontrollet taktike dhe operacionale në terren. "Me datën 5 shtator rreth orës 19:40 është pranuar një informacion se nga fshati Debëlldeh - Viti janë duke lëvizur disa automjete të

dyshuara, në mesin e tyre njëra dyshohej se kishte të ngarkuar mallra të kontrabanduara të sjella nga Maqedonia Veriore përmes rrugëve ilegale, në ndërkohë që dy automjete të tjera kanë bërë përcjelljen e saj. Pas pranimit të kësaj informate njësitë operative nga Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare - Lindje kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme

operativo-taktike me ç'rast janë realizuar prita dhe kontrolle në rrugët e brezit kufitar dhe në rrugët dytësore të fshatrave të Vitisë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia ka njoftuar se si rezultat i veprimeve të marra, njësitë policore kanë arritur ta ndalojnë automjetin e dyshuar me targa vendore me drejtues të dyshuarin

mashkull kosovar, me ç'rast, gjatë kontrollimit, është gjetur një sasi e konsiderueshme e barnave të llojeve të ndryshme (24 lloje të barnave si: Daleron, Xanax, Sintrom 4, Kalcium Karbonat, Dilakor 0.25mg, Andoll 100 mg, Promolut Nor 5mg, Helex 0.25 mg etj.) të cilat janë sjellë në mënyrë ilegale nga Republika e Maqedonisë së Veriut në

Republikën e Kosovës. "Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori kompetent i cili ka urdhëruar që personi i dyshuar të ndalohet për 48 orë, ndërsa malli i kontrabanduar të dërgohet në terminalin doganor. Rasti i kompletuar u dërgohet njësite kompetente për trajtim të mëtutjeshëm", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.



cilat, siç u tha në letër, çojnë drejt përparimit të dialogut Kosovë - Serbi që ndërmjetësohet nga BE-ja. "Tensionet e kohëve të fundit kanë treguar se hapat konstruktivë në rrugën përpara janë urgjentisht të nevojshëm, në nivelin praktik dhe politik. Propozimi ynë është që

këshilltarët të bëjnë një vizitë të përbashkët me Miroslav Lajçakun në Kosovë dhe Serbi, në mënyrë që t'i gjejnë opsionet, që procesi të lëvizë shpejt përpara", thuhet në letrën dërguar Kurtit dhe Vuçiqit.

Më 27 gusht Kosova dhe Serbia janë pajtuar që të heqin dorë nga

lëshimi i dokumentit për hyrjedalje për shtetasit e të dy vendeve. Kosova dhe Serbia kanë marrëveshje për lëvizje të lirë që prej vitit 2011.

Serbia e ka zbatuar atë menjëherë dhe për 11 vjet ua ka lëshuar qytetarëve të Kosovës këtë lloj dokumenti. Kur Qeveria e

Kosovës ka vendosur ta zbatojë këtë pikë të marrëveshjes më 1 gusht, serbët në veri të Kosovës kanë rritur tensionet përmes vendosjes së barrikadave. Qeveria e Kosovës e ka shtyrë më pas zbatimin e vendimit për 1 shtator, mirëpo ndërkohë palët janë marrë vesh për moslëshimin e

tyre.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur 11 vjet më parë. Kosova insiston që dialogu për normalizim të marrëdhënieve të përmbyllet me njohje reciproke në mes të dy vendeve. Serbia, në anën tjetër, kërkon zgjidhje nëpërmjet kompromisit.

Diskutohet për bashkëpunimin në mes të MAPL-së dhe NDI-së

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka pritur në takim drejtorin e NDI-së për programet në Evropën Qendrore dhe Jugore, Robert Benjamin dhe drejtoreshën e NDI-së në Kosovë, Nancy Soderberg. Gjatë këtij takimi u diskutua për zhvillimin ekonomik lokal, iniciativat ligjore, programet e

MAPL-së, duke u fokusuar te grupet e margjinalizuara dhe komunitetet, si dhe fuqizimin e barazisë gjinore në nivelin lokal. Ministri Krasniqi, gjithashtu, nënvizoi edhe çështje të tjera përmes të cilave mund të ketë bashkëpunim në mes të MAPL-së dhe NDI-së në të ardhmen dhe ka falënderuar Benjamin për përkrahjen e vazhdueshme të NDI-së për institucionet e

Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, Benjamin ka falënderuar ministrin Krasniqi për pritjen dhe ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e mbështetjes për MAPL-në dhe nivelin lokal, duke u fokusuar në iniciativat të cilat mbështesin grupet e margjinalizuara dhe demokratizimin në nivelin lokal.



Hoxha dhe Ferraj, bijtë politikë të Muho Asllanit dhe Lenka Qukos!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Ideologët sllavo-komunistë, përcaktues të ADN-së shqiptare: Të gjitha partitë politike në Kosovë në radhët e veta kanë mbetje politike dhe biologjike të ish-regjimeve të Jugosllavisë dhe Serbisë, të sistemuar si është më së miri; si këshilltarë politikë, deputetë, ministra dhe zëvendësministra, ambasadorë dhe konsuj, profesorë universitarë, në diplomaci, medie, në polici, prokurori, gjyqësorë, me një fjalë janë shpërndarë si metastaza malinje në të gjitha segmentet e shoqërisë kosovare, prandaj edhe jemi si jemi, ende në mjegull dhe pa një përcaktim të qartë për të ardhmen tonë, si komb dhe si shtet. Asnjë proces në Kosovë, që nga përfundimi i luftës, nuk është zhvilluar pa këta biseksualë politikë dhe kombëtarë për faktin se e kanë pasur përkrahjen e plotë ndërkombëtare të cilët kërkojnë hyzmeqarë që ua kryejnë punët më lehtë dhe sipas projekteve të tyre. Nderkaq, të tillët, me ADN të

përshtatjes ndaj çdo pushtuesi legal dhe ilegal ka qenë ajo “armata e karkalecëve” që ka shkatërruar dhe shkretuar çdo ide për liri të vërtetë dhe bashkim kombëtar. Me daljen në skenë të LV-së që si projekt kryesor e kishte bashkimin kombëtar, midis shumë projekteve të tjera që 100 % frymonin kombëtarisht, u servua një ushqim shpirtëror për idealistët dhe patriotët e vërtetë për faktin se subjektet e tjera kishin filluar të brehen nga krimbi që në një mënyrë e relativizonte qenien dhe përcaktimin kombëtar si shqiptarë, kurse e afirmonte një komb inekzistues, kombin kosovar. Këta ishin xhokerët e LV-së sa ishte në opozitë derisa erdhi në pushtet. Tash me asgjë nuk ndryshon nga partitë e tjera në Kosovë. Madje, në përputhje me fuqinë e votave prej 51 %, në atë masë ndoshta edhe më shumë e ka rritur dhe fuqizuar praninë e trashëgimtarëve politikë dhe kombëtarë të ish-

Jugosllavisë dhe të ish-Serbisë duke e shtuar si “si vlerë demokratike” edhe një grup stalinist - enverist nga Shqipëria që portretizohen si njerëz shumë me ndikim në LV e që janë pararoja politike e LV-së. Në fakt, këta nuk janë asgjë më shumë se një grup injorantësh racistë që mendojnë se janë superiorë në aspektin intelektual, politik dhe kulturor ndaj kosovaristëve, siç i cilësojnë qytetarët e Kosovës pa të cilët asnjëherë Shqipëria nuk do të ishte shtet dhe as që do të ekzistonte si shtet përveç se do të ishte banovinë e ish-Jugosllavisë dhe ish-Serbisë gjë që edhe e pranuan pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore; Shqipëria si republikë e shtatë e Jugosllavisë. Dihej dhe dihet qartazi se kush e formoi Partinë Komuniste të Shqipërisë, kush udhëhiqte politikën e Jashtme të Shqipërisë, ekonominë, arsimin, policinë, ushtrinë dhe segmentet e tjera të

shtetit shqiptar. Ishin Dushan Mugosha, Milladin Popoviq, Tempo, Stojniq, dizdareviqët, rankoviqët dhe të ngjashmit që vrisnin e kthjellnin në Shqipëri. Kryengritjen e Shaban Polluzhës, bashkë me dapçeviqin, e shuan, në gjak dhe terror, edhe partizanët shqiptarë të Shefqet Peçit. Edhe Masakra e Tivarit nuk ishte bërë pa dijeninë e komunistëve shqiptarë që, në heshtje, duke mos e kundërshtuar, e miratuan këtë. Dhe shumë e shumë të tjera. Me një fjalë, askush dhe asgjë nuk dëmtoan shqiptarët, Shqipërinë dhe viset ku jetojnë shqiptarët se komunizmi. Madje, e them se shqiptarët dhe Shqipëria do të duhej të ishin të fundit në botë që do ta përkrahnin komunizmin!

Diçka që ndërlihet me titullin: Sa ishim në vuajtje të dënimit në llogoret e ish-Jugosllavisë dhe Serbisë e që, në fakt, ishin një dhe e vetme, ishim mirë të informuar për

zhvillimet në Jugosllavi nga mediet e atëhershme që i kishim mjaftueshëm, mirëpo kishim mungesë të informatave për Shqipërinë që e kishim idealizuar sikur të ishte edhe mbi Amerikën. Prandaj, me të gjitha mundësitë angazhoheshim për të siguruar një radio të vogël të cilën e kontrabandonim duke paguar një çmim të kripur, qoftë për ta blerë brenda ambienteve të llogorit ose, nëse vinte nga jashtë, korruptonim ndonjë të burgosur, të besueshëm për aq sa mund t'i besohej, që ta fuste brenda. Për kuriozitet, asnjëherë i burgosuri kontrabandues nuk na ka denoncuar tek autoritetet e llogorit. Mendoj se kanë pasur frikë se mund t'i humbnin beneficionet e mëdha që i gëzonin si të dënuar të sjellshëm. Për burgun në Foçë dhe qendrën e paraburgimit në Mostar ku ishim, Skender Kastrati, Rexhep Mala, Agim Sylejmani dhe unë, për radio përkujdeseshin Rexhepi dhe

Skenderi, kurse në llogorin në Stara Gradishkë, Baca Adem Demaçi e shfrytëzoi autoritetin e jashtëzakonshëm që e kishte te të gjithë të burgosurit, duke e bindur një të dënuar politik kroat, inxhinier me profesion, që në kutinë ku vendosej sapuni, ta montonte një radio që e ndërtoi vetë dhe i cili ishte shumë i përdorshëm dhe vështirë i identifikueshëm shkak i maskimit të mirë. U krijuan të gjitha kushtet që çdo ditë përmes Revistës Radiofonike të Mbrëmjes të Radio Tiranës të informohemi. Më vonë doli se jemi dezinformuar, për Shqipërinë dhe rreth Shqipërisë. Në kontekst të interesimit patriotik bënim përpjekje ta mbajmë mend përbërjen e Politbyrosë së Shqipërisë të cilin pastaj ua përcillim të burgosurve të tjerë. Një kohë të gjatë, pasi Baca donte të pushonte pak, kjo radio m'u dorëzua mua me ç'rast, përveç lajmeve që i emitonte Shqipëria, i përcillja edhe lajmet e agjencive botërore të informimit në gjuhën serbo-kroate, të cilën e njihja sikur edhe gjuhën shqipe. Pastaj, në brifingun e mëngjesit u tregoj lajmet që kishin të bënin me zhvillimin në Kosovë dhe rreth Kosovës. Ama, lajmeve nga Shqipëria nuk u besoj fare, sidomos në fushën e zhvillimit ekonomik ku mbizotëronin lajmet se në kooperativën këtë e këtë kishte aq lopë, del, kuaj, dhi, gomarë etj., për rendimentet e grurit, për elektrifikimin e çdo vendi, për ndërtimin e rrugëve të reja, për përrurimin e ujësjellësve të shumtë dhe të tjera. Të gjitha këtyre të "arriturave" iu paraprinte ai që kishte merita: Partia e Punës e Shqipërisë dhe shoku Enver Hoxha sa ishte gjallë... I mësoja emrat e anëtarëve të Politbyrosë, ndërsa i veçoja dy emra, Muho Asllani dhe Lenka Quko. Emrin Muho e lidhja me muha që në shqip është miza, kurse Lenka e merrja si një emër 100 për qind sllav. Pasi dola nga burgu dhe shkova në Shqipëri, për herë të parë në vitin 1990, u binda se të gjitha sukseset që i dëgjua në lajme, në fakt ishin gënjeshtër, mirëpo edhe si gënjeshtër, sa ishim në vuajtje të dënimit, na mbanin sepse Shqipërinë e shihnim me sytë tanë, me zemrat tona, ashtu siç kishim dëshirë të ishte. Gjatë bisedës me disa personalitete të informuara mirë, kërkova të dija më shumë për Muho Asllanin dhe Lenka Qukon, si quadro të forta dhe premtues të PPSH-së. Më thanë se Muho Asllani ishte zgjedhur anëtar i Politbyrosë së Shqipërisë, si karrocieri më i mirë i Shkodrës, kurse Lenka Quko ishte zgjedhur si anëtarë si mjelësja më e mirë e lopëve në

Shqipëri! Elvis Hoxha është mbase këshilltari kryesor dhe më me ndikim, bashkë me Veton Surroin, i kryeministrit Albin Kurti! Që të dy me bindje të fortë komuniste, por me një jetë ekstravagante që është në kundërshtim të plotë me botëkuptimin komunist. Elvis Hoxha përkulet para Sartrit, që ka qenë intelektual i madh, por edhe komunist - anarkist edhe më i madh! Mbase edhe i Sllavoje Zhizhekut, që ka përmbajtje të njëjtë me Sartrin. Elvis Hoxha paguhet mirë nga buxheti i Kosovës për qëndrimin nënçmues, injorant dhe racist ndaj "kosovaristëve" në krye me Rrahman Jasharajn të cilit ia cakton edhe përkatësinë nacionale serbe përmes ADN-së komuniste -anarkiste. Duhet të jesh së paku një idiot e të mendosh si Elvis Hoxha si për "kosovaristët" ashtu edhe për Rrahman Jasharajn. Elvis Hoxha, si paraardhës i babait politik, Muho Asllanit, do të bëhet kryekarrocieri që do ta rikthejë Shqipërinë dhe shqiptarët në "kafazin e artë" të komunizmit të Dushan Mugoshës dhe Miladin Popoviqit, të cilët, mbase, i do shumë! Para më haram se që i shpenzon buxheti i Kosovës duke e paguar një injorant anarkist si puna e Elvis Prilli Hoxhës, nuk ka! Elvis Hoxha është skajshmërisht i keq, shpjegueshëm i keq, i cili poshtërsinë dhe të keqen e përdor për përfitime politike dhe, sidomos ato materiale. Po t'i mbledhësh të gjithë të paditurit e LV-së, nuk do të bënin më shumë dëm se një pordhë patriotike e Elvis Hoxhës. Për LV-në, pa asnjë dyshim. Prandaj morën aq vota në zgjedhjet në Shqipëri! Hysamedin Ferraj është njeri i grushtit, jo kundër Serbisë, por në nderim të idhullit politik që e kishte, nr. 1, Enver Hoxhën dhe numër 2, Lenka Qukon. Mund të shpallet një ndër mjelësit më të suksesshëm dhe më të pamerituar të buxhetit të Kosovës. Përrallave të tij për bashkim kombëtar dhe bashkim me Shqipërinë nuk iu besojnë aspak, as Elvis Hoxha dhe as Albin Kurti. Edhe ky kishte merita të jashtëzakonshme për "fitoren" e madhe të LV-së, në zgjedhjet e fundit në Shqipëri! Dështoi në garë për deputet të Kuvendit të Kosovës, prandaj u emërua (nga kryeministri Kurti) si këshilltar që koordinon marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës. Nëse i kemi parasysh se çfarë marrëdhënie janë me Shqipërinë, atëherë do ta keni të qartë tërë potencialin destruktiv që e përdor për t'i minuar këto marrëdhënie, shoku Hysamedin (Azemi) Ferraj! E mira e së mirës do të ishte që kryeministri Kurti t'i jap një rrogë shokut

Hysamedin me vetëm një kusht: t'i ndërpresë angazhimet dhe kontributin për normalizim të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës. Gjatë bombardimeve të NATO-s në Serbi u paraqit një slogan në pankarta: "Sllobo, dosta si nas branio..."), (Sllobo, mjaft na ke mbrojtur ...). Në aspektin e kontributit kombëtar, një pordhë e Rrahman Jasharajt është më kontribuuese se "angazhimi kolosal dhe vetëmohues" i Elvisit dhe shokut Hysamedin. Nuk është ky i pari Hysamedin në Kosovë që aq shumë po kontribuon. Para tij ishte Hysamedin Azemi, jo vetëm emnak i shokut Hysamedin!

Një panik dhe nguti krejtësisht e panevojshme: LV-ja ka pushtet absolut në Kosovë në saje të 51 % të votave. Kjo nënkupton se ka qenë një disponim për ndryshime me të cilat ka ardhur në pushtet LV-ja. Nuk ka pasur qeveri që nuk ishte kundërshtuar nga opozita se që ishte dhe është LV-ja. Opozita nuk ka numra ta rrezojë LV-në, mirëpo jam i sigurt se edhe nëse do të kishte këtë mundësi, nuk do ta bënte këtë. Nuk do të merrte përgjegjësi për marrje të vendimeve të rënda dhe të dhimbshme. Nuk ka gatishmëri të përballet me krizën, thuaja të papërballueshme edhe në Kosovë, ndër të tjera, si pasojë edhe e krizës së përgjithshme botërore. LV-ja ka komoditet t'i realizojë të gjitha premtimet sepse nuk ka kush ta kundërshtojë. Nuk ka opozitë, nuk ka vullnet opozitar sikur që opozita nuk dëshiron t'i mbajë "këmbët e arushës", pasi ia ka lënë në duar LV-së. Pasi LV-ja ka dashur, me çdo kusht dhe me çdo mjet ta marrë pushtetin, pa i studiuar mirë rrethanat brenda vendit, e sidomos ato të jashtme, politike dhe ekonomike. Pastaj, garnitura udhëheqëse, si në qeveri e sidomos në Kuvend e pozitës, është mizerabële. E tmerrshme. E pashpresë. Ky është takati i tyre politik dhe intelektual! Nuk ndez më arsyetimi se të gjitha këto janë pasojë e 20 vjetëve të kaluara për faktin se e kanë pasur të qartë se në çfarë gjendje po e marrin pushtetin. Në rrethana aktuale, askush mos të gënjejë dhe të gënjejë se do t'i zgjidhte këto probleme, por se duhet që këto probleme të menaxhohen për ta siguruar mbijetesën e qytetarëve të Kosovës. Më askush nuk u beson se janë për bashkim kombëtar, se e duan flamurin kombëtar e jo flamurin e Kosovapetrolit, se do t'i rishqyrtojnë të gjitha marrëveshjet e nënshkruara në Bruksel, se nuk do ta pranojnë, me asnjë kusht

Zajebnicën, se do ta mbyllin Gjykatën Raciste Speciale dhe shumë të tjera. Importi i mallrave nga Serbia është mbi 600 milionë në vit, nuk ka më kamionë të rrotulluar (kryesisht të shqiptarëve) që transportojnë mallra serbe. Oligarkët tash janë bërë patriarkë të pushtetit. E vetmja opozitë e mirëfilltë është Kimete Berisha, disa analistë dhe gazetarë që kishin shumë adresa më parë, dhe krahu i luftës i LV-së, PSD-së. Me forcën politike që e ka Albin Kurti dhe qeveria, sikur edhe me deputetë në Kuvend, kryeministri nuk do të duhej të kishte asnjë problem, asnjë ankh apo makth. Mirëpo, të gjitha këto ia shkaktojnë të paaftët e vet, që vetë i ka emëruar, vetë i mban dhe vetë i ushqen. Po si është e mundur që, përkundër të gjitha këtyre problemeve, nuk është shkaktuar asnjë ministër, zëvendësministër apo zyrtar, kurse përgjegjësi kërkon nga opozita që, sipas mandatit që e ka, nuk ka asnjë përgjegjësi që Rrahman Jasharajn e trajton si armik, kurse zotin Bërnabiq si mik! Së fundi ua ndërroi vendin dy zëvendësministrave e që ma kujton një barsolë me një familje shumë të varfër, pa kushte minimale për jetë. Një ditë zonja e shtëpisë u thotë fëmijëve, 10 sa i kishte, se të shtunën në orën 11.00 duhet të jenë në shtëpi sepse do t'ua ndërrojë brekët. Fëmijët e gëzuar u renditën në kohën e paraparë në shtëpi, me gëzim se do t'i ndërrojnë brekët që asnjëherë nuk i kishin ndërruar më parë. Zonja e shtëpisë fillon ndërrimin e brekëve me: Xhaviti do t'i veshë brekët e Xhevatit, Xhymshiti brekët e Behxhetit, Halimi brekët e Nysretit, Sandokani brekët e Tarzanit dhe Xhevrija brekët e Shehrijesë... Në këtë mënyrë edhe kryeministri Kurti do ta bëjë, sa duket reformatimin e qeverisë. Sot në Qeverinë e Kosovës ka ministra, krejtësisht koprofesionale që e luajnë rolin e hetuesit, prokurorit, gjykatësit, auditorit, censorit, zëdhënësit e më së paku rolin që ia përcakton posti. Qeveria po bën gabime të panevojshme, se po ngutet shumë, pa asnjë nevojë kur tërë pushtetin e ka në duar dhe i cili nuk rrezikohet nga askush. Në vend që Albin Kurti më shumë kohë t'i kushtojë opozitës se pozitës, ai panevojshëm dhe pafalshëm e poshtëron dhe e fyen opozitën dhe, vetëm kur t'i vijë veza te b..a, e lajmëron opozitën se çfarë marrëveshje ka nënshkruar apo rinënshkruar, pasi është falur Bajrami. Kryeministri Kurti duhet që para çdo takimi dhe vendimi ta takojë opozitën dhe të konsultohet me të, të ndërtojë një bashkëpunim të

domosdoshëm apo konsensus për vendime të mëdha, të vështira apo të dhimbshme. Ai tërë këtë ia beson një injoranti amblematik si është puna e Besnik Muçivercës. Krijon ndasi te shqiptarët e Luginës, krijon tensione me Edi Ramën që, për këta tanët është Ajnshtajni, e frynë dhe pastaj e shfrynë Zijadin Selën në Maqedoni, luan çok.. me Dritan Mashtruesin në Mal të Zi etj. Qeveria është e vetëdijshe se asnjë vendim të madh, as brenda e sidomos në planin e jashtëm nuk mund ta marrë pa opozitën. Deklarohet që është qeveri që nuk shantazhohet, por shantazhin, me vetëm 0.5 % nuk mendon si qeveria, deklarohet kundër punësimeve partiake dhe nepotizmin, ndërkohë që këto dukuri i ka shndërruar në art. Deklarohet për shtet të së drejtës dhe pushtete të ndara në kohën kur nuk e lë asnjë prokuror dhe gjykatës pa e kërcënuar dhe pa e shantazhuar. I varte shumë shpresat te Elezi të cilin e përgjeroni të kthehet për ta përmbushur premtimin: "Le të shkojë Lumezi, le të vijë Elezi"... në ndërkohë që Lumezi shkoi... për t'u rreshkur diku në det, kurse Elezi e kuptoi se duan ta bëjnë vegël... dhe nuk erdhi. Doli të jetë shumë i mençur! Ndaj ish-pushtetarëve, ku me të drejtë e ku me të padrejtë e përdorën të gjithë arsenalin që edhe jetën ua rrezikuan seriozisht, miellosjen e Hekuranit e ngritën në nivel të sakrificës së Adem Jasharit! Po nguten nga padurimi që ish-drejtuesit ushtarakë dhe politikë të Kosovës, që po mbahen peng në Gjykatën Raciste në Hagë, ende nuk e kanë marrë dënimin me burg të përjetshëm. Hashim Thaçit i kërkoni të raportojë edhe për një gotë uji që e ka pirë gjatë bisedimeve në Bruksel, kryeministri Kurti iu drejtohet Rakiqit dhe serbëve të tjerë që t'i regjistrojnë veturat me tabela të Kosovës me ç'rast u premtun kursime deri në 5 000 euro, pagesë të rrymës, ujit, mbeturinave, tatimit në pronë dhe mosheqje nga lista e pagave për punën që nuk e bëjnë për Kosovën, por e bëjnë për Vuçiqin dhe Serbinë. Çfarë sikleti, përveç atij manipulativ kishte kryeministri Kurti që, në ditën e diel, ditë pushimi, e zgjoi nga gjumi kryeparlamentarin, shokun Glauk dhe, pa asnjë procedurë apo vendim qeveritar, e dorëzoi Ligjin për Vetingun?! Pse nuk prite deri të hënën që ishte ditë pune dhe ishin në pyetje dallimi vetëm disa orë?! Albin Kurtit dhe LV-së do t'i vijë pashmangshëm faturat e Bacës Adem Demaçi, sepse ai që e vret Atin e vet, nuk mund të ketë fund të mirë. Uroj të mos jem i saktë!

LDK-ja: Pakoja e qeverisë, joefektive dhe diskriminuose

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 6 shtator - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shprehur shqetësimin për pakon ekonomike të paraqitur nga qeveria Kurti. Deputeti Besian Mustafa, në një konferencë për medie, ka thënë se qeveria këtë fundjavë paraqiti një pako të re, në panik e sipër, pa ndonjë konsultim. Ai ka theksuar se kjo pako është joefektive dhe diskriminuose. "Shumica e masave janë të vonshme, nuk janë të planifikuara mirë, dhe do të kenë pak ose fare efekt, njëjtë sikurse masat e kaluara të kësaj qeverie. Për LDK-në ky është veprim në panik i qeverisë, për ta ulur pakënaqësinë në rritje, për ta blerë paqen sociale, në vend se të jetë një plan i menduar mirë për ta zgjidhur krizën. Qeveria ka vendosur t'i injorojë tërësisht të punësuarit në sektorin privat dhe sektorin privat, të cilët janë kontributdhënësit më të mëdhenj tatimorë dhe motorët

e ekonomisë sonë. Nga të punësuarit në sektorin privat kjo qeveri vetëm merr e asgjë nuk jep", ka thënë Mustafa. Ai ka thënë se asnjë cent, po ashtu, nuk u dha as të papunëve. "Pra, ata që nuk kanë asnjë të hyrë, qeveria vendosi t'i injorojë tërësisht! Kjo pako qartësisht nuk ofron mbështetje për të gjithë qytetarët dhe është diskriminuose. Është diskriminuose për shkak se shkakton pabarazi, duke u ndarë vlerën e njëjtë edhe atyre me 300 euro rrogë, edhe atyre me 2 000 euro rrogë. Pra, si roja si drejtori ekzekutiv i PTK-së marrin të njëjtën përkrahje nga kjo qeveri. Është e paqartë se si një qeveri që pretendon që është qeveri social-demokrate nuk qan kokën për barazi, sidomos kur shpërndan para publike", ka thënë ai. Deputeti i LDK-së ka thënë se qeveria po tenton të propozojë një ligj për çështjen e investimeve kapitale, por ky ligj është duke ardhur shumë vonë. Sipas tij, asnjë investim kapital



serioz nuk mund të fillojë e mbarojë për tre muaj. "Qeveria nuk mori parasysh as propozimet e LDK-së për zbutjen e ndikimit të inflacionit si reduktimi i akcizës dhe i TVSh-së në derivate të cilat do të ishin shumë më efektive se

masat e ndërmarrja. Qeveria nuk konsultohet me asnjë ekspert tjetër relevant, odat ekonomike apo grupe të tjera se si të përmirësohet kjo situatë ekonomike katastrofike. E thërrasim qeverinë që të trajtojë këtë krizë me seriozitet

dhe përfundimisht të përqendrohet në masa konkrete që zhblokojnë potencialin e zhvillimit ekonomik, t'i përshpejtojnë projektet kapitale dhe ta përmirësojnë jetën e qytetarëve të Kosovës", ka thënë deputeti Mustafa.

AKK-ja shqyrton Projektligjin për Zyrtarët Publikë dhe Projektligjin për Paga

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kryesitë e dy kolegjiave të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në takim të përbashkët shqyrtojnë Projektligjin për Zyrtarët Publikë dhe Projektligjin për Paga. Për këto projektligje, të cilat janë në diskutim publik, kryesitë e AKK-së i kanë dhënë vërejtjet, propozimet dhe rekomandimet. Këto vërejtje, propozime dhe rekomandimet do të përcillen përmes shkresës zyrtare në grupet punuese qeveritare. Projektligji për zyrtarët publikë parasheh që menaxhmenti i mesëm dhe i ulët të mandatohen me afat vetëm prej katër vjetësh. Kjo u kundërshtua nga të gjithë



anëtarët, me ç'rast është kërkuar që nenet që e parashohin këtë rregullim të mos përfshihen në ligjin e ardhshëm. "Propozohet që të mbetet në fuqi rregullimi aktual, pra që të mos ketë ndryshime në këtë aspekt. Projektligji i propozuar eliminon procesin e avancimit

në detyrë, transferimin në pozita të ngjashme brenda institucioneve dhe kërkesa e AKK-së është që pozitat e menaxhmentit të mesëm dhe të ulët të rregullohen me akt emërimi të përhershme ashtu siç është e rregulluar me ligjin aktual", ka njoftuar AKK-ja. Shërbimi civil në Kosovë është

i ndërtuar mbi karrierë. Investimet që janë bërë dhe bëhen në administratë edhe në personel kanë ndikuar dhe ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të tyre e që kjo shndërrohet me automatizëm në ofrim të shërbimeve më të mira për qytetarët. Ndërrimi i zyrtarëve çdo katër vjet do të krijojë shumë probleme në institucione, nuk do të ketë stabilitet, zyrtarët nuk do të paraqesin interesim të madh për ngritje të kapaciteteve të tyre, pasi nuk do të dihet edhe e ardhmja e tyre. Në Kosovë është punuar mjaft shumë për të arritur në këtë nivel, jemi shembull për rajonin për stabilitetin në administratë, u theksua në këtë takim, andaj nuk do t'i bënte mirë Kosovës ndryshimi

i shpeshtë i stafit menaxhues sepse do të humbej kontuniteti i punëve në vazhdimësi. Po ashtu, kishte edhe propozime të tjera rreth procedurave, afateve ku u kërkuar disa qartësime sa i përket procesit të rekrutimit në nivel lokal. Sa i përket Projektligjit të Pagave, propozimi i AKK-së vazhdon të jetë i njëjtë pozitiv e njëjtë - pagë e njëjtë, po ashtu është e nevojshme të bëhen disa ndërhyrje te disa pozita të caktuara, që presim të diskutohen në takimin e radhës të grupit punues. Kolegji i Zyrtarëve Ligjorë mbajti takim tjetër dhe, përveç shqyrtimit të projektligjeve në fjalë, u diskutuan disa çështje juridike edhe rreth situatës aktuale.

Oda e Afarizmit: Rritja e pagave në sektorin privat, vështirë e realizueshme

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Vendimi i Qeverisë së Kosovës, që sektori privat t'i rrisë pagat e punëtorëve me subvencionim prej 50-përqindësh deri në 100 euro në tre muajt e parë, është parë vështirë i zbatueshëm nga Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK). Kjo odë, me anë të një komunikate për medie, ndonëse e ka përshëndetur vendimin e qeverisë, ka thënë se problemet me inkasimin e mjeteve financiare dhe sigurimi i qëndrueshmërisë financiare i

bizneseve e bën të vështirë rritjen e pagave. "Në kuadër të kësaj pakoje është kushtëzimi prej 50-përqindësh i rritjes së pagës deri në 100 euro për tre muajt e parë. Realizimi i së njëjtës do të jetë shumë i vështirë për një pjesë të madhe të bizneseve, pasi punëdhënësit e sektorit privat, e që janë shumicë, do ta kenë shumë vështirë ta bëjnë ngritjen e pagave për punëtorët e tyre për shkak se kanë probleme me inkasim të mjeteve dhe sigurim të qëndrueshmërisë financiare

për bizneset e tyre në mënyrë që të njëjtat të mos falimentojnë", është thënë në komunikatën e OAK-ut. OAK-u ka potencuar mosndihmesën financiare të bizneseve në periudhën e reduktimeve me energji elektrike, sipas së cilës, ka shkaktuar humbje të mëdha. Po ashtu, OAK-u ka kërkuar një takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që të diskutohet për tejkalimin e krizës ekonomike në vend.



A është fajtores edhe Evropa për krizën energjetike?



Këtë verë pushimet në shumë qytete gjermane janë pak më ndryshe se sa zakonisht. Ata që frekuentojnë pishinat në Hanover, në veriperëndim të vendit, detyrohen të bëjnë një dush me ujë të ftohtë pas larjes. Edhe udhëtimet në Berlin janë pak më pak spektakolare se zakonisht, pasi qyteti ka vendosur të fikë dritat që ndriçojnë gjatë natës 200 atraksionet turistike kryesore. Më 23 qershor, Ministria e Ekonomisë dhe Klimës, lëshoi një alarm për konsumin e gazit: "Situata është alarmante, dhe nuk përjashtohet një përkeqësim i mëtejshëm i saj" - thuhej në deklaratë. "Nord Stream 1", gazsjellësi kryesor që transporton gazin rus në Gjermani dhe prej andej në pjesën tjetër të Evropës, pritet t'i nënshtrohet këto ditë një "mirëmbajtjeje" të paplanifikuar. Sceptikët thonë se vendimi i marrë nga Moska, vendi ku nis gazsjellësi i madh, është një hakmarrje për mbështetjen e saj të Evropës ndaj Ukrainës, e cila po e spraps pushtimin rus. Mbetet ende e paqartë nëse furnizimet përmes "Nord Stream 1" do të rifillojnë më 2 shtator siç është deklaruar zyrtarisht. Moska ka thënë se synon të furnizojë me vetëm 20 për qind të kapacitetit të përgjithshëm të gazsjellësit, ndërsa vendet e Bashkimit Evropian kanë

shpallur synimin e tyre për të reduktuar me 15 për qind konsumin e gazit. Por ndërsa po e kufizon konsumin e saj energjistik përpara një dimri të vështirë, Gjermania vazhdon të dërgojë gaz përmes territorit të saj në pjesë të tjera të Evropës. E njëjta gjë vlen edhe për energjinë elektrike. Megjithëse kohët e fundit çmimet kanë arritur nivelet më të larta historike, Gjermania vijon të furnizojë me energji elektrike Francën, ku furnizimi është edhe më i kufizuar. Kjo situatë është pasojë e një nisme në nivel evropian, e nisur për herë të parë në vitin 1996 dhe e përforcuar në vitet 2003 dhe 2009, e krijuar për të siguruar një konkurrencë më të madhe, për të shkatërruar monopolet në energjistikë, dhe për garantuar sigurinë e furnizimit. Por paaftësia për të zbatuar plotësisht të ashtuquajturin liberalizim të tregut, mund të sjellë efektin e kundërt për kontinentin. Liberalizimi duhej të siguronte që të gjithë qytetarët në Evropë të mbështeteshin tek një furnizim i bollshëm dhe i vazhdueshëm me energji. Vendet do të kishin më shumë fuqi vendimmarrëse, duke rënë dakord së bashku për kushtet me prodhuesit e mëdhenj të karburanteve fosile. Po ashtu, kontratat do të nënshkruheshin me çmime të vendosura nga

qendrat e reja të ngritura për të mbuluar tregun evropian. "Nëse jemi të bashkuar, jemi më të fortë. Ky ishte koncepti. Procesi, që përfshinte gjithashtu transparencë më të madhe, u pa si makthi më i keq i Rusisë. Por siguria e furnizimit me energji, përfaqësoi një objektiv pothuajse dytësor, në krahasim me garantimin e një çmimi të drejtë dhe të përmbajtur për furnizimet" - thotë Tier Bros, profesor i çështjeve energjetike në Universitetin e Parisit, Sciences Po. Duke e krahasuar me situatën e viteve 1990 - kur secili vend kishte tregun, monopolin dhe politikën e tij proteksioniste energjetike - me atë aktuale, pra me një treg të integruar dhe me organe rregullatore, çmime fleksibël dhe siguri më të madhe, nisma ishte padyshim një sukses thotë Gana Gladik, studiues në Aleancën Evropiane të Kërkimeve mbi Energjinë. Gjithsesi ajo e pranon se disa nga aspektet që janë cilësuar si pozitive, kanë kontribuar edhe në problemin e furnizimit me energji, me të cilin po ndeshet aktualisht Evropa. "Nuk ekziston një treg i përsosur" - shton ajo. Bros, që ishte pjesë e procesit të liberalizimit të tregut francez dhe integritetit të tij në tregun evropian të energjisë, thotë se

situata me të cilën përballemi sot nuk përfaqëson një dështim të tregut, por një dështim të enteve rregullatore. Aktualisht, vendet janë lënë të kujdesen për veten e tyre, dhe mund të marrin një sërë vendimesh të ndryshme në lidhje me integritetin e tyre energjetik, për sa kohë që ato përfshihen në udhëzimet e BE-së. Disa vende kanë preferuar gazin me kosto të ulët, në vend të diversifikimit të burimeve. Edhe pse direktivat e BE-së mbi energjinë, përcaktojnë se çdo vend duhet të ketë të paktën 3 burime të veçanta të furnizimit me gaz, që furnizimet të ndahen në një mënyrë sa më të barabartë të jetë e mundur, vendet e tjera, si Gjermania, mbështeten tek Rusia si furnitori ityre kryesor. Bros beson se ky vendim është marrë duke ditur se nëse gjërat shkojnë keq, do të ndërhyjnë vendet e tjera evropiane. "Nuk mund të quhet liberalizim, nëse secili mund të bëjë çfarë të dojë. Nëse do të kishim zbatuar të gjitha rregullat, sot do të ishim më të fortë" - thekson ajo. Një problem tjetër, është se ai që duhet të jetë një front i bashkuar, shpesh nuk është edhe aq harmonik. Projekti i gazsjellësit "Nord Stream 2", një zgjatim i "Nord Stream 1" që duhet të transportojë gaz nga Rusia në

Evropën kontinentale, u mbështet nga Gjermania dhe Austria dhe u kundërshtua nga vende të tjera evropiane, përfshirë Poloninë, Ukrainën dhe shtetet baltike. Ky projekt u pezullua kur Rusia pushtoi Ukrainën. Për më tepër, plani evropian nuk merr parasysh asnjë shqetësim jashtë Evropës. "Ai merret me gjithçka që është e brendshme, por jo me faktorë të jashtëm, të cilët ndonjëherë janë të paparashikueshëm" - thotë Gladik. Këtu përfshihet pushtimi nga Rusia i një vendi sovran si Ukraina, dhe reagimi ndërkombëtar, së bashku me sanksionet ekonomike. Gjermania nxiti idenë se tregtia do të nxiste ndryshime politike në Rusi. Por nga këndvështrimi i sotëm, kjo ide duket shumë naive. Një aspekt tjetër që duhet marrë parasysh, është se tregu i brendshëm evropian i energjisë, parashikoi një kalim më të shpejtë tek burimet e rinovueshme, sesa ndodhi në të vërtetë. Gladik, që ka punuar për qeverinë ukrainase kur Rusia ndërpreu furnizimin me gaz të vendit në vitin 2014, nuk është i sigurt nëse një strukturë e ndryshme tregu, do ta kishte izoluar Evropën nga goditjet e jashtme të 6 muajve të fundit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Hajdari: Besojmë se do të kemi një kampionat të suksesshëm

PEJË, 6 SHTATOR - Afati kalimtar në basketbollin e Kosovës ishte mjaft i bujshëm, ndërsa shumë lojtarë u rikthyen në skuadrat që dikur ishin pjesë e rëndësishme. Një ndër ta është edhe Art Hajdari, i cili u rikthye te Peja. Ai në fillim ka folur për përgatitjet me verdhezinjtë. “Në stërvitje jemi duke u angazhuar maksimalisht. Deri më tani kemi zhvilluar disa ndeshje miqësore, që do të na shërbejnë për t’u komponuar sa më mirë për edicionin e ri”, ka thënë Hajdari për faqen zyrtare të FBK-së.

Ky kampionat pritet të jetë shumë interesant, pasi të gjitha skuadrat janë përforcuar. “Ne do të bëjmë përpjekje maksimale që t’i arrijmë qëllimet tona. Kemi bërë një punë të mirë në përgatitje dhe kjo të na ndihmojë në edicionin e ri, që është në prag të fillimit. Të gjitha skuadrat kanë bërë përf forcime dhe po pritet një garë shumë interesante në elitë. Me ndihmën e tifozëve besoj se mund t’i arrijmë qëllimet tona”, ka



shtuar ish-basketbollisti i Ponte Prizrenit.

Peja në fundjavë do t’i nisë garat me ndeshjen derbi ndaj Sigal Prishtinës në kryeqytet. “Do të ketë shumë ndeshje

interesante dhe derbi. Asnjë ndeshje nuk do të jetë e lehtë, andaj duhet ta japim maksimumin në çdo takim”, ka deklaruar Hajdari. Edicionin e kaluar Peja kishte fituar Ligën Unike.

Hajdari: Besojmë se do të kemi një kampionat të suksesshëm

PEJË, 6 SHTATOR - Afati kalimtar në basketbollin e Kosovës ishte mjaft i bujshëm, ndërsa shumë lojtarë u rikthyen në skuadrat që dikur ishin pjesë e rëndësishme. Një ndër ta është edhe Art Hajdari, i cili u rikthye te Peja. Ai në fillim ka folur për përgatitjet me verdhezinjtë. “Në stërvitje jemi duke u angazhuar maksimalisht. Deri më tani kemi zhvilluar disa ndeshje miqësore, që do të na shërbejnë për t’u komponuar sa më mirë për edicionin e ri”, ka thënë Hajdari për faqen zyrtare të FBK-së.

Ky kampionat pritet të jetë shumë interesant, pasi të gjitha skuadrat janë përforcuar. “Ne do të bëjmë përpjekje maksimale që t’i arrijmë qëllimet tona. Kemi bërë një punë të mirë në përgatitje dhe kjo të na ndihmojë në edicionin e ri, që është në prag të fillimit. Të gjitha skuadrat kanë bërë përf forcime dhe po pritet një garë shumë interesante në elitë. Me ndihmën e tifozëve besoj se mund t’i arrijmë qëllimet tona”, ka shtuar ish-basketbollisti i Ponte Prizrenit.

Peja në fundjavë do t’i nisë garat me ndeshjen derbi ndaj Sigal Prishtinës në kryeqytet. “Do të ketë shumë ndeshje interesante dhe derbi. Asnjë ndeshje nuk do të jetë e lehtë, andaj duhet ta japim maksimumin në çdo takim”, ka deklaruar Hajdari. Edicionin e kaluar Peja kishte fituar Ligën Unike.



SHKURT

UEFA cakton gjyqtarët për ndeshjen Ballkani - Cluji

UEFA ka caktuar gjyqtarët që do të ndajnë drejtësinë në ndeshjen në mes të Ballkanit dhe Clujit. Pasi arriti suksesin historik duke siguruar pjesëmarrjen në grupet e Ligës së Konferencës, kampionët e Kosovës janë gati për ta nisur aventurën e re në këtë garë. Në ndeshjen e parë në kuadër të Grupit G, skuadra e drejtuar nga Ilir Daja do të përballlet me Clujin e Rumanisë. Ndeshja në fjalë do të zhvillohet më 8 shtator në stadiumin “Fadil Vokrri”. UEFA për këtë ndeshje ka caktuar gjyqtarët nga Zvicra për ta ndarë drejtësinë. Urs Schnyder do të jetë gjyqtari kryesor, kurse Marco Zurcher dhe Zurcher Benjamin do të jenë ndihmësit e tij. Sven Wolfensberger është caktuar për në rolin e gjyqtarit të katërt.

Sadriu kalon te Mura

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës U21 në futboll, Leard Sadriu, ka nisur një aventurë të re në karrierën e tij. Ai është transferuar në kampionatin slloven te Mura. Klubi nga elita e futbollist slloven ka njoftuar se Sadriu ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2025. 21-vjeçari së fundi luajti si i huazuar te Skënderbeu nga Shkëndija derisa te Mura ai do ta gjejë futbollistin tjetër kosovar Mirlind Daku.

Muja: Për shkak të lëndimit nuk jam paraqitur për Antwerpenin

Transferimi i Arbnor Mujës tek ekipi belg Royal Antwerp ishte një nga transferimet që bëri më së shumti bujë në futbollin e Kosovës. Muja, përkundër transferimit të gjiganti belg, ende nuk e ka bërë debutimin e tij me këtë skuadër. Muja për “Kanal10” tregoi arsyet se pse nuk është aktivizuar deri më tani me Antwerpenin. “Mosaktivizimi im deri më tani nuk ka qenë shkak i dokumentacionit, por është problem i një lëndimi. Në lojën e parë kundër Antwerpit e kam pësuar një lëndim në fund të ndeshjes, ndërsa në lojën e dytë kam luajtur i lënduar. Në fillim kam menduar se është çdo gjë mirë, por më pas ka qenë një lëndim serioz në ‘hamstring’. Kur kam filluar stërvitjet me Antwerpenin, pas ekzaminimeve mjekësore e kam parë që jam i lënduar. Kam qenë jashtë fushave për gjashtë javë dhe kjo është java e fundit e rikuperimit. Nga java tjetër shpresoj se do të jem pjesë e ekipit dhe të kem minuta”, ka thënë Muja.

Boshllëku i lënë nga Lewandowski në Bayern pritet të mbulohet nga Kane

MUNCHEN, 6 SHTATOR - Largimi i Robert Lewandowski ka lënë një gropë të madhe te Bayern Muncheni. Afrimi i Sado Manes nuk shihet si një zgjidhje përfundimtare, por si një lëvizje për të fituar pak më shumë kohë. Sipas të

përditshmes gjermane "Bild", Bayerni ka një projekt të qartë, një ide fikse që përpara se të largohet sulmuesi polak. Klubi gjerman kërkon t'i sigurojë shërbimet e Harry Kanes, të cilat nuk i realizoi dot këtë verë, për shumë arsye, por ka nisur

punën tani për t'i siguruar shërbimet e kapitenit të përfaqësueses angleze. Drejtuesit e Bayernit kanë vendosur kontaktet e para me përfaqësuesin e Harry Kanes, me vëllanë e tij, për të bërë të mundur transferimin e Kanes

sezonin e ardhshëm. Kane ka një kontratë të vlefshme me Tottenham Hotspurin deri më 30 qershor 2024. Nëse sulmuesi nuk firmos rinovimin e kontratës me "gjelat", Bayerni do të paraqesë një ofertë zyrtare për "bomberin" anglez.



Bunjaku: Do të bëjmë maksimumin për të mbrojtur titullin

SUHAREKË, 6 SHTATOR - Golden Eagle Ylli është kampion në dy vitet e fundit në basketbollin e Kosovës. Therandasit në fundjavë nisin misionin për mbrojtjen e titullit, por që nuk do të jetë aspak lehtë. Valon Bunjaku është rikthyer te Ylli dhe flet për përgatitjet. "Po mundohemi që të përgatitemi sa më mirë për edicionin e ri. Kampionati fillon shumë shpejt dhe duhet të jemi sa më të gatshëm", është shprehur Bunjaku për faqen zyrtare të FBK-së. Ylli në përballjen e parë do të sfidohet nga Rahoveci, ndërsa të gjitha skuadrat kanë bërë përforsime. "Ylli është kampion dhe sigurisht se nuk është lehtë të mbrosh titullin. Sidoqoftë, do të bëjmë përpjekje maksimale të arrijmë qëllimet tona", ka shtuar tutje basketbollisti i Përfaqësueses së Kosovës. Kampionët e Kosovës për herë do të marrin pjesë në kualifikimet e Ligës së Kampionëve, ku do të ndeshen me Benficën, ndeshje që zhvillohet më 21 shtator në Portugali. "Për ne është shumë e rëndësishme të kemi paraqitje sa më të mira në garat



ndërkombëtare. E dimë se sa të rëndësishme janë këto gara, jo vetëm për klubin tonë, por edhe basketbollin e Kosovës, andaj do të angazhohemi maksimalisht për paraqitje sa më të mirë", ka deklaruar Bunjaku. Ylli gjithashtu do të garojë në Ligën Unike, ku ishte finalist edicionin e

kaluar. Superkupa Mbarëkombëtare do të zhvillohet më 5/6 tetor në Mitrovicë, ku therandasit shpresojnë të përsëritin suksesin e edicionit të kaluar. Golden Eagle Ylli kishte mundur në finale Sigal Prishtinën në Shkodër. Ky ishte trofeu i parë i kësaj gare.

Sonte dy derbi në Ligën e Kampionëve



MILAN, 6 SHTATOR - Italia do të jetë epiqendra kryesore e ndeshjeve të futbollit, pasi sonte (e mërkurë) do të zhvillohen dy derbi në Ligën e Kampionëve. Interi e pret në Milano skuadrën kampione të Gjermanisë, Bayern Munchen, në kuadër të grupit C, i cili konsiderohet "grupi i ferrit" e në të cilin bën pjesë edhe

Barcelona. Kjo e fundit e pret në "Cam Nou" Viktoria Plzenin. Ndeshje tjetër interesante do të zhvillohet në kuadër të grupit A, ku Napoli e pret skuadrën e Liverpoolit. Ndeshja tjetër zhvillohet në këtë grup mes Ajaxit dhe Rangersit. Në Grupin B Atletico Madridi e pret Porton, ndërsa Bayer

GRUPI A

18:45 Ajax - Rangers
21:00 Napoli - Liverpool

GRUPI B

21:00 Atletico Madrid - FC Porto
21:00 Club Brugge - Bayer Leverkusen

GRUPI C

21:00 Barcelona - Viktoria Plzen
21:00 Inter - Bayern Munchen

GRUPI D

18:45 Eint. Frankfurt - Sporting CP
21:00 Tottenham Hotspur - Marseille

Leverkuseni i shkon Club Brugges. Në grupin tjetër, atë D, do të përballen Eintracht Frankfurt-Sporting CP dhe Tottenham Hotspur-Marseille.

Ricciardo: Të gjithë skenarët janë të mundshëm

Daniel Ricciardo nuk do të jetë pjesë e McLaren në vitin 2023. Sezoni i ardhshëm në Formula 1 është i paqartë për pilotin Daniel Ricciardo, i cili nuk do ta vazhdojë bashkëpunimin me

McLarenin. 33-vjeçari ka folur së fundmi për planet e tij dhe nuk ka përjashtuar mundësinë që të nënshkruajë si pilot zëvendësues për ndonjë skuadër. "Jam goxha i hapur për të gjitha skenarët.

Mendoj se ka të mira dhe të këqija nga të gjithat. Ka të mira edhe nëse pushoj nga F1 për pak kohë. Aktualisht, 18 muajt e kaluar kanë qenë më shumë sfidues, kështu që ndoshta pak kohë larg do të

jetë e mirë", ka thënë Ricciardo. "Por, pastaj, të qëndroj aktiv është mirë. Kjo është pse dua t'i dëgjoj të gjitha ofertat. Edhe nëse është si rezervist. Nuk dua të jem krenar dhe të them se

jam shumë i mirë për atë", ka shtuar australianin. Daniel Ricciardo këtë edicion është i 13-ti në ranglistën e përgjithshme të Formulës 1. Ai ka grumbulluar 19 pikë këtë edicion.

SHKURT

Nadali eliminohet nga US Open

Tenisi spanjoll Rafael Nadal është eliminuar në çerekfinale të turneu US Open nga tenisti amerikan Tiafoe me rezultatin 3-1. Një ndeshje e madhe që zgjati 3 orë e 32 minuta, ndërsa vendimtar ishte seti i fundit pasi u luajt 1 orë e 2 minuta dhe u fitua nga 24-vjeçari amerikan. Tiafoe në raundin e 1/8 do ta gjejë përballë rusin Andrey Rublev, i cili fitoi bindshëm 0-3 me sete përballë anglezit Cameron Norrie.

Mbappe: Macroni kërkoi që të mos largohem nga PSG-ja

Kylian Mbappe ka folur për verën e komplikuar që kaloi në lidhje me të ardhmen e tij, teksa vendosi ta rinovonte kontratën me PSG-në edhe pse ishte pranë transferimit te Real Madridi. Ai tregoi një prapaskenë interesante në lidhje me një bisedë me Macronin. "Kurrë në jetën time nuk e prisja që të flisja me presidentin Macron për të ardhmen time si futbollist. Kjo është absurde. Ai më tha se donte që unë të qëndroja në Francë, se nuk donte që unë të largohesha sepse jam shumë i rëndësishëm për vendin. Dhe kur të thotë presidenti, ka një rëndësi të madhe", ka thënë Mbappe, i cili nuk e ka përjashtuar që një ditë të transferohet në Real Madrid.

Dembele: Nuk kemi frikë nga Bayerni, jemi gjithmonë favorit në LK

Në grupin e ferrit të Ligës së Kampionëve bëjnë pjesë skuadra si Barcelona, Bayern Munchen, Inter dhe Viktoria Plzen. Për këtë grup ka folur Ousmane Dembele. "Barcelona është një nga favoritët në Ligën e Kampionëve? Barça është gjithmonë mes favoritëve, bashkë me skuadra të tjera të mëdha si Real Madrid dhe Liverpool. Duhet ta nisim grupin e Ligës së Kampionëve në mënyrën më të mirë të mundshme, jo si vitin e kaluar kur kemi humbur 3-0 kundër Bayernit dhe më pas kundër Benficës me të njëjtin rezultat", ka thënë Dembele. "Duhet ta nisim me një fitore. Nëse kemi frikë nga Bayerni? Jo, nuk kemi frikë. Duam ta mundim Bayernin sepse na ka mundur sezonin e kaluar dhe atë paraardhësin", ka shtuar Dembele.

Pjaniqi do të largohet nga Barça, shkon te Sharjah

Mesfushori Miralem Pjaniqi do të largohet nga Barcelona edhe përkundër asaj se nuk është larguar në afatin kalimtar të verës. Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka konfirmuar vendimin e Pjaniqit për t'u larguar nga "Camp Nou". "Pjaniqi ka vendosur të largohet për më shumë mundësi. Ai ka qenë një profesionist i madh, kështu që mendoj se ai kishte shanse këtu, por secili zgjedh rrugën e vet", ka deklaruar trajneri spanjoll. Mesfushori boshnjak shumë shpejt pritet të zyrtarizohet te klubi nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Sharjah FC. 32-vjeçari do të nënshkruajë kontratë trivjeçare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:642/1
Dt:06.09.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë dhe Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikë, 11 orë mësimore; Një (1) mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Mekatronikës, 20 orë mësimore;	Vend i lirë Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Gjermane (20 orë mësimore);	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trynisi, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 3 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë dhe Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



QENDRA E KOMPETENCËS
"SHTJEFËN GJEÇOVI"
Prishtinë



Prishtinë 10000 Kosovë. Rruza "TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Nr. 645/1

Dt.06.09.2022

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1 – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin për të rritur, Drejtoria e Arsimit, shpall :

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimin për të rritur në Qendrën e Kompetencës "SHTJEFËN GJEÇOVI" në Prishtinë, për vitin shkollor 2022/2023, afati i Janarit.

Për këto profile :

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues-----24 nx.
- Automekanik-----24 nx.
- Mekatronikë-----24 nx.
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit-----24 nx.
- Floktari-----24 nx.
- Konfeksioner-----24 nx.
- Rrobaqepës-----24 nx.
- Transport rrugor-----24 nx.
- Trafik rrugor-----24 nx.
- Transport hekurudhor (Drejtues i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave). -----24 nx.

KUSHTET :

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimi për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Partecipimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- a) Për regjistrim të vitit për një klasë100,00 €
- b) Për praktikë profesionale50,00 €
- c) Për provim diferencial 10,00 €
- d) Provimi përfundimtar /certifikata – diploma50,00 €

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Ud. Blerim Gërvalla



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Elzë Hajdari shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë dhe njëmbëdhjetë të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

► Ardit Lila nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Petrit Ceni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII Diplomën dhe certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

► "Iconix" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811558214.

► "Ideade" Sh.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810070681.

► "Natyra" Sh.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810548729.

► "A&A Coatings" Sh.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810548216.

► "Lami Project", shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me nr: 330172388.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

u Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

u Lëshoj lokal në qira. Lokal është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokal gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

u Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

u Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

u Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

u Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

u Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

u Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

u Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

u Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

u Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

u Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

u Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales